



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 701, Datë 30.07.2020

“Për mos klasifikimin si përqendrim të transferimit të veprimtarisë ekonomike të degëve të shoqërive HIPPO Markets tek shoqëria SPAR Albania Shpk”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 30.07.2020, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mos klasifikimi si përqendrim i transferimit të veprimtarisë ekonomike të degëve të shoqërive HIPPO Markets tek shoqëria SPAR Albania Shpk.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”, dhe formulari të plotë të njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve dhe informacionit mbi transaksionin mes shoqërive HIPPO Markets dhe shoqërisë SPAR Albania Shpk,

VËREN SE :

Transaksioni dhe përqendrimi

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, është depozituar njoftimi lidhur me transferimin e veprimtarisë ekonomike të degëve të shoqërive HIPPO Markets (shtatë prej pikave) tek shoqëria SPAR Albania Shpk

Pala Shitëse: HIPPO MARKETS është një rrjet supermarketesh i themeluar në Shqipëri në nëntor të vitit 2015. Pjesë e rrjetit HIPPO Markets janë shtatë supermarkete, të cilat ofrojnë një gamë të gjerë artikujsh për klientët e tyre. Këtu përfshihen artikujt ushqimorë dhe jo-ushqimorë, produktet e enëve të kuzhinës dhe produktet kozmetike. Të gjitha supermarketet ndodhen në Tiranë dhe secila prej tyre operon si njësi e veçantë ekonomike-ligjore, e regjistruar në Qendrën

Kombëtare të Regjistrimit, si më poshtë: *Meleon Tirana Shpk, Meleon Shpk, HIPPO Shpk, XL Market Shpk, MAXI HIPPO Shpk, HIPPO STUDENTI Shpk* dhe *Hippo Tregu Elektrik Shpk*,

Pala Blerëse: SPAR ALBANIA SHPK (“SPAR AL”) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e cila zotërohet 100% të kapitalit prej shoqërisë Balfin SHPK. SPAR AL nuk zotëron kontroll në asnjë shoqëri tjetër dhe ka për objekt aktiviteti shitjen me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore, produkte për kafshë etj., nëpërmjet ngritjes dhe administrimit të marketeve, supermarketve dhe hipermarketeve “SPAR” në Shqipëri dhe jashtë saj. Gjithashtu në aktivitetin e SPAR AL përfshihet import-eksport dhe prodhim i produkteve jo-ushqimore, stokimi dhe ruajtja e produkteve ushqimore, transport i mallrave dhe udhëtarëve brenda dhe jashtë vendit etj.

Vlerësimi i përqendrimit

Më datë 01 Tetor 2019 është nënshkruar “Marrëveshja për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike të Degës së Ndërmarrjes”, ndërmjet shoqërive SPAR Albania Shpk nga njëra anë dhe MELEON TIRANA Shpk nga ana tjetër. Më datë 09 Shtator 2019 është nënshkruar “Marrëveshja për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike të Degës së Ndërmarrjes”, ndërmjet shoqërive SPAR Albania Shpk nga njëra anë dhe Meleon Shpk nga ana tjetër. Më datë 12 Shtator 2019 është nënshkruar “Marrëveshja për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike të Degës së Ndërmarrjes”, ndërmjet shoqërive SPAR Albania Shpk nga njëra anë dhe XL Market Shpk nga ana tjetër. Më datë 15 Gusht 2019 është nënshkruar “Marrëveshja për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike të Degës së Ndërmarrjes”, ndërmjet shoqërive SPAR Albania Shpk nga njëra anë dhe HIPPO Shpk nga ana tjetër. Më datë 09 Shtator 2019 është nënshkruar “Marrëveshja për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike të Degës së Ndërmarrjes”, ndërmjet shoqërive SPAR Albania Shpk nga njëra anë dhe MAXI HIPPO Shpk nga ana tjetër. Më datë 25 Shtator 2019 është nënshkruar “Marrëveshja për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike të Degës së Ndërmarrjes”, ndërmjet shoqërive SPAR Albania Shpk nga njëra anë dhe HIPPO STUDENTI Shpk nga ana tjetër. Më datë 04 Shtator 2019 është nënshkruar “Marrëveshja për Transferimin e Veprimtarisë Ekonomike të Degës së Ndërmarrjes”, ndërmjet shoqërive SPAR Albania Shpk nga njëra anë dhe HIPPO TREGU ELEKTRIK Shpk nga ana tjetër.

Marrëveshjet e depozituara konsistojnë në transferimin e veprimtarisë së degës së ndërmarrjes të përbërë nga zërat aktiv dhe pasiv të bilancit të shtatë shoqërive, duke përfshirë: asetet e përdorura nga transferuesi për ushtrimin e aktivitetit të tij ekonomik; mallrat e ambalazhet gjendje në magazinë në datën efektive; punonjësit operacional të punësuar efektivisht në datën efektive dhe kontratat përkatëse të punës. Shoqëritë që transferohen do të vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas transferimit dhe nuk do të kenë ndryshim të strukturës së pronësisë. Veprimtaritë ekonomike që do të transferohen, do të veprojnë dhe funksionojnë si njësi autonome, pra të pavarura nga shoqëritë nga të cilat do të shpëputen. Dega e ndërmarrjes do të transferohet e lirë nga çdo barrë dhe detyrim shoqërisë SPAR AL, përveç detyrimeve të përcaktuara posaçërisht në Marrëveshjet përkatëse.

Mbështetur në nenin 10 të Ligjit nr.9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe pikës 14, 16 dhe 20 të Udhëzimit “Mbi Kontrollin e Përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”,

miratuar me vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.236, datë 19.07.2012, këto marrëveshje do të sjellin një situatë kontrolli në treg edhe pse nuk kanë për pasojë marrjen e kontrollit të pronësisë të shoqërive palë në marrëveshje.

Për vlerësimin e një situate të tillë, Komisioni i Konkurrencës, nëpërmjet Rrjetit Rajonal të Konkurrencës, bëri një Kërkesë Informale për Informacion (RFI) në të cilin u parashtrua objekti i marrëveshjeve të depozituar nga shoqëria Spar Albania SHPK dhe iu kërkuar autoriteteve të konkurrencës së rrjetit, vlerësimi i përqendrimeve sipas legjislacionit kombëtare si dhe qëndrimin e tyre ndaj këtij rasti.

Komisioni, për vlerësimin e transaksionit të transferimit të veprimtarisë ekonomike të marketeve Hippo tek SPAR AI, iu referua:

- Rastit M.7940 (NETTO / Grocery Store at Armitage Avenue Little Hulton) i KE, ndodhur midis dy shoqërive që operonin në tregun e shitjes me pakicë në UK. Transaksioni konsistonte në shitjen e objekteve të shitjes, bosh, nga shitësi tek blerësi së bashku me licencën për shitjen e pijeve alkoolike. Komisioni, mbështetur në Rregulloren 139/2004 të KE vendosi që transaksioni i njoftuar nuk përbënte përqendrim.
- Rastit No. 1163/2019 Maxima Bulgaria Ltd./11 dyqane, në Bullgari, i cili konsistonte në lidhjen e kontratave afatgjate të qerasë me 11 dyqane, ku qiramarrësi do të përdore asetet e shoqërive dhe markën. Në përfundim të vlerësimin, Komisioni Bullgar i Konkurrencës nuk e klasifikoi si përqendrim transaksionin e njoftuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mos klasifikimin si përqendrim të transferimit të veprimtarisë ekonomike të degëve të shoqërive HIPPO Markets tek shoqëria SPAR Albania Shpk.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS